




Paketa fiskale 2022 heq kompensimin 6% të TVSH-së të prodhuesit, vë taksë për qumështin pluhur; Përpunuesit e qumështit: ...

Faqe 2



Gjermani - Shqipëri, bashkëpunim për objektivat e zhvillimit të bujqësisë

Faqe 4



Brenda 2022-shit krijohet regjistri i fermave

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural, Frida Krifca deklaroi se ...

Faqe 4



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15 ditëshi i parë i muajit nëntor 2021

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 425
Çmimi 125 lekë

E përdijavshme e pavarur

TAKSA TË REJA PËR BUJQËSINË, KASH: PENGOHET PRODHIMI VENDAS

PAKETA FISKALE DISKUTOHET TË "VEPRIMTARIA PRODHUESE", AGROBIZNESI: S'ËSHTË KONSULTUAR, DËMTON BUJQËSINË. TË BËHET STUDIM I THELLUAR!

Agrobiznesi kërkon që këto ndryshime të propozuara të mos hyjnë në fuqi pa u bërë studimi i thelluar me dëmin që do i shkaktohet biznesit në sektorin e bujqësisë në rast se këto masa hyjnë në fuqi

RISI ALBANIA

- Punësimi i të rinjve - Turizmi dhe Agrobiznesi sektor potencial

Projekti Zviceran për punësimin e të rinjve, RisiAlbania adreson papunësinë e të rinjve në Shqipëri që nga viti 2013



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Ekonomia e qëndrueshme arrihet me prodhim-eksport, jo me konsum-import

Sot po diskutohet për rritjen e normës së inflacionit, për rritjen e çmimit të bukës, të qirave, të transportit etj. etj. Shumë mirë bëhet, sidomos me rritjen e çmimit ...




Partner for Growth

Faqe 7

PROFIL

- Kooperativistja që u bë biznesmene - Historia e eksportueses së madhe që e nisi biznesin duke shitur domate në rrugë

Faqe 5

ABA ONLINE

Teknologjitë digjitale transformojnë bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit



Faqe 2



Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra "Kondor", Tiranë;
Cel.: 0672035581; 0684855580



Koyo. bepeco FAG

Faqe 11, 12

KËNDI I EKSPERTIT

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË,
SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

Faqe 11, 12

RisiAlbania mbështet realizimin e Udhëzuesit për “Ndërtimin dhe Zhvillimin e Marrëdhënieve të Bashkëpunimit në tregun e punës”

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive mblodhi në një tryezë të rrumbullakët drejtorët rajonalë të Zyrave të Punësimit për të prezantuar Udhëzuesin për “Ndërtimin dhe Zhvillimin e Marrëdhënieve të Bashkëpunimit me Punëdhënësin dhe Analizën e Tregut Rajonal të Punës”.

Takimi i përbashkët, ndi-

hmoi në ndarjen e përvojës së zbatimit të udhëzuesit gjatë vitit të fundit në Drejtoritë Rajonale e Zyrat Vendore të Punësimit e trajnimit të stafit.

Ky udhëzues është realizuar me mbështetjen e projektit RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe ka për qëllim forcimin e

bashkëpunimit me punëdhënësin, rritjen e cilësisë dhe produktivitetit të shërbimeve ndaj punëdhënësit dhe njëhësimin e shërbimeve në të gjitha zyrat tona.

Udhëzuesi i hartuar sipas standardeve më të mira do të shërbejë si një manual në marrëdhëniet e bashkëpunimit në tregun e punës.

Progresraporti i KE-së, Krifca: Adresim kapitujve për fshatin dhe bujqësinë

Komisioni European ka publikuar raportprogresin për Shqipërinë duke vlerësuar sektorin e bujqësisë për një sërë përparimesh gjatë këtij viti.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca u shpreh për vëmendje ndaj raportit të Komisionit Evropian mbi progresin e Shqipërisë për

tre kapitujt e zhvillimit rural, sigurisë ushqimore dhe peshkimit.

“Evropa ka vlerësuar përparimin e ndodhur me ecurinë në peshkim, programin IPARD për aftësinë, standardet dhe kapacitetet e ngritura si dhe politikat e ndërmarrja në veterinarin, etj.”, tha ministria.

Ajo vuri në dukje se, kemi punë të madhe përpara për të adresuar rekomandimet të cilat kërkojnë këmbëngulje dhe dedikim për të tre kapitujt.

“Planin e punës dhe aksionet e veprimit i kemi fare të qarta për të avancuar integrimin në Bashkimin European për fshatin dhe bujqësinë”, deklaroi Krifca.

Paketa fiskale 2022 heq kompensimin 6% të TVSH-së te prodhuesit, vë taksë për qumështin pluhur; Përpunuesit e qumështit: Ndryshimet janë rrënuese, do rrisin çmimet

Në paketën fiskale 2022 priten 3 ndryshime të taksave me efekt në rritjen e kostos për industrinë e përpunimit të qumështit.

Në paketën e re fiskale që iu është dërguar për konsultim grupeve të interesit qeveria parashikon heqjen e TVSH-së të rimbursueshme për blerjet nga 6% që është aktualisht, vendosjen e taksës 100 lekë për kilogram për qumështin pluhur të importit dhe përjashtimin nga TVSH-ja për importimin e makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimeve me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë nga 50 milionë lekë që është aktualisht.

Ndryshimet fiskale janë pritur me shqetësim nga industria e përpunimit të qumështit që prej 3 vitesh vuan shtimin e kostove nga ndryshimet e skemës të rimbursueshme të TVSH-së. Industrialistët pohojnë se nëse ndryshimet do të miratohen do të shkaktojnë shumë dëme për prodhimin e produkteve të bulmetit dhe pritet të ndikojnë te rritja e çmimeve të tyre deri me 30%.

Projektligji “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”

Në projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar propozohet që norma e kompensimit



të prodhuesit bujqësor të bëhet 0 % nga 6% që është aktualisht dhe të zëvendësohet me skema subvencionimi. Prej vitit 2019, TVSH-ja që kompensohet në blerje është 6% nga 20% që ishte para ndryshimit. Me nisjen e zbatimit të skemës të ndryshuar të TVSH-së nga 2019 vështirësitë në aktivitetin e përpunuesve të qumështit janë rritur nga viti në vit. Për shkak të ndryshimeve fiskale të 3 viteve më parë në tregje vihet re rritje e produkteve të importuara, që konkurrojnë nga çmimi produktet vendase. Në kahun tjetër shumë fabrika nuk kanë arritur të mbijetojnë, pasi ndryshimi i TVSH-së ka shtuar informalitetin.

Në relacionin e draftit thuhet se heqja e skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë dhe zëvendësimin e saj me subvencionim direkt të sektorit të bujqësisë, procedurë që është më e lehtë për

tu monitoruar dhe kontrolluar nga pikëpamja fiskale është rekomanduar Fondi Monetar Ndërkombëtar. “Me anë të këtij projektligji, propozohet që, norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor të bëhet 0 për qind nga 6 për qind që është aktualisht. Kjo, pasi edhe nga zbatimi në praktikë i deritanishëm, mendohet se nga skema e kompensimit, prodhuesit bujqësorë objekt të kësaj skeme, nuk kanë marrë kompensimin sikundër është parashikuar dhe ka synuar kjo skemë, duke e bërë këtë të fundit jo funksionale”, citohet në relacion.

Një tjetër ndryshim fiskal i cili pritet të shtojë sërish kostot e industrisë është ai në Projektligji “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, ku përjashtimi nga TVSH-ja për importimin e makinerive dhe pajisjeve në

(Vijon në faqen 4)

Skema Kombëtare në Bujqësi, 250 fermerë përfitues në 5 masa mbështetëse

Është shtuar edhe me 16 fermerë numri i aplikantëve përfitues në dy masat e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi dhe Blegtori për vitin 2021.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) njofton se ka ulur për të shtatën herë vijën e financimit për aplikimet në 2 masa mbështetëse të fermerëve sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE.

Sipas AZHBR-së, numri rendor i aplikantëve që janë përfshirë mbi vijën e financimit, për:

Masa 3: Zëvendësim plastmazi në serra ekzistuese – Vija e financimit ishte në numrin rendor 593 – Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 608.

Masa 4: Mbajllje Bimë Aromatike dhe mjekësore –Vija e

financimit ishte në numrin rendor 117- Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 118.

Afati i dorëzimit të doku-

Sipas AZHBR-së, deri tani pagesat janë dhënë për 95 % të fermerëve përfitues ose 3 000 fermerë në të gjithë vendin. Skema Kombëtare e



menteve shtesë për aplikantët që ndodhen mbi vijën e financimit është deri më datë 03.11.2021. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.

Nga ulja e vijës së financimit, numri i përfituesve është shtua me mbi 250 fermerë në 5 masa mbështetëse.

Mbështetjes në Bujqësi 2021, ka të destinuar një fond prej 804 milionë lekë, subvencione për fermerët.

Sipas të dhënave zyrtare janë 3200 fermerë të kualifikuar deri tani përfitues për njëherë nga 9 masat që mbështet Skema Kombëtare e këtij viti.

Teknologjitë digjitale transformojnë bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit

Pranueshmëria dhe mobiliteti i teknologjive digjitale po transformojnë bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit.

Në mënyrë të veçantë, në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, përhapja e teknologjive të lëvizshme, shërbimet në distancë tashmë, po përmirësojnë aksesin e pronarëve të vegjël në informacion, inpute dhe tregje, duke rritur produktivitetin, përmirësuar zinxhirët e furnizimit dhe duke minimizuar kostot operacionale.

E tillë është edhe platforma ABA Online që shfrytëzon fuqinë e teknologjive digjitale për të pilotuar, përshpejtuar dhe shkallëzuar ide novatore me potencial të lartë dhe ndikim në bujqësi, duke transfor-

muar zgjidhjet dhe shërbimet digjitale në të mira publike.

Fredi Llanaj fermer nga zona e Vlorës, thotë se është tashmë një përdorues i platformës digjitale dhe ka arritur të kryejë marrëveshjen e parë tregtare online.

“Kam shitur një sasi prej 20 tonë shalqi duke u lidhur me një biznes nga Kosova. Përmes platformës online ne kemi lehtësi të konsultohemi, të marrim çmimet reale të tregut për prodhimet bujqësore dhe rrisim shitjet jo vetëm në tregun vendas, por edhe në eksporte”, tha Llanaj.

E krijuar në fillim të këtij viti, për të qenë platforma e qasjeve të reja, ABA Online, ka fuqizuar familjet rurale dhe

frymëzuar sipërmarrjen e të rinjve në bujqësi. Lehtësisht e aksesueshme nga çdo smartfon, ABA online është interaktive dhe plotëson nevojat e fermerëve të vegjël shqiptarë në çdo hap të rritjes së biznesit të tyre.

Është themeluar si një iniciativë e Projektit për Përfshirjen Financiare të Fermerëve të Vegjël Shqiptarë (FIAS), mbështetur nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA) dhe zbatuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. ABA online ofron informacion thelbësor për fermerët dhe bizneset duke ndikuar në këtë mënyrë në zinxhirin e vlerës.

Naftë falas për bujqësinë, 19 365 fermerë përfitues

Me mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për herë të parë këtë vit u mundësua mbështetja e fermerëve me naftë falas.

19 365 fermerë nga 12 qarqe të vendit përfituan nga skema e naftës falas për bujqësinë.

Sipas të dhënave nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, subvencionimi i naftës për bujqësinë ka pasur një interes të shtuar nga fermerët për të përfituar naftë pa taksë për punët në bujqësi.

Janë shpallur të vlefshme 19 365 aplikime me rreth 4.1 mil-

ionë litra naftë për një sipërfaqe prej rreth 31 558 hektarë foragjere dhe misër.

Ndërsa në fazën e parë të aplikimit, në skemën e mbështetjes naftë pa taksë për bujqësinë, 15 janar – 30 mars

2021, aplikuan mbi 20 mijë fermerë në shkallë vendi.

Kjo masë mbështetëse reduktoi ndjeshëm kostot e fermerëve në prodhim e për pasojë dhe çmimet për konsumatorin.



PAKETA FISKALE 2022

TAKSA TË REJA PËR BUJQËSINË, KASH: PENGHET PRODHIMI VENDAS, DO RRITEN ÇMIMET

PAKETA FISKALE DISKUTOHET TË “VEPRIMTARIA PRODHUESE”, AGROBIZNESI: S’ËSHTË KONSULTUAR, DËMTON BUJQËSINË. TË BËHET STUDIM I THELLUAR!

Agrobiznesi kërkon që këto ndryshime të propozuara të mos hyjnë në fuqi pa u bërë studimi i thelluar me dëmin që do i shkaktohet biznesit në sektorin e bujqësisë në rast se këto masa hyjnë në fuqi

Paketa fiskale e propozuar nga Ministria e Financave, nuk është konsultuar me bizneset prodhuese dhe me sektorin e bujqësisë. Drejtoresha ekze-

në sektorin privat, por edhe në buxhet nga masat e propozuara janë pa dyshim shumë më të mëdha se sa shifra që parashikohet se mund të përfitohet

prodhuesi shqiptar, unë ta blej me TVSH-në 0 dhe ta shes me 20% të mbytur produkti i Bosnjës dhe i Serbisë në Shqipëri. Më thonë ju ta blej unë me zero lëndën e parë

het në të gjitha hallkat.

“Ajo që më ka shqetësuar është TVSH-ja. Ne TVSH e trajtojmë si një problem të shkëputur, por më jepni një ek-

milionë lekë, sepse është tati mbi qarkullimin. Mund të bësh përjashtime tek shërbimet, por jo në qarkullimin e mallrave, me taton mua që në doganë pa

Binaj kontabilist dhe ekspert fiskal i KASH.

“Një nga arsytet pse po vjen kjo paketë fiskale është edhe presioni i madh që vjen nga



kutive e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, Enida Shena në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, tha se pavarësisht se buxheti i shtetit pret një rritje të ardhurash nga heqja e rimbursimit të TVSH-së për bujqësinë, vendosjes së tarifës 10% për inputet bujqësore apo tavani i përjashtuar nga TVSH-ja sa i takon investimeve në bujqësi, këto ndryshime dëmtojnë bizneset.

Agrobiznesi kërkon që këto ndryshime të propozuara të mos hyjnë në fuqi pa u bërë studimi i thelluar me dëmin që do i shkaktohet biznesit në sektorin e bujqësisë në rast se këto masa hyjnë në fuqi.

“Impakti financiar pozitiv në buxhet që pretendohet sipas përlloraritjeve të hartuesve të Paketës fiskale parashikohet rreth 1 miliardë e 750 milionë lekë të reja. Por hartuesit P/ buxhetit dhe Paketës fiskale nuk kanë studiuar dhe nuk janë ballafaquar me sektorin privat, për të llogaritur edhe pasojat negative dhe dëmin që i shkaktohet sektorit privat, veçanërisht sektorit prodhues nga reduktimi buxhetit dhe taksat, tatimet e tarifës shtesë që propozohen në Paketën fiskale.

Sipas parashikimeve dhe vlerësimit paraprak të ekspertëve tanë efektet negative

në buxhet nga masat e propozuara:

Propozimi yne është: Taksat, tatimet dhe tarifët shtesë të propozuara në Paketën fiskale që shoqëron Projektbuxhetin e vitit 2022 të mos hyjnë në fuqi, pa u përfunduar studimi dhe pa u ballafaquar me sektorin privat mbi efektet negative, që do të reflektojnë masat e propozuara në të gjitha hallkat e zinxhirit të Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri dhe për rrjedhojë edhe në buxhetin e shtetit”, thotë Enida Shena, drejtoreshë e Agrobiznesit.

Kreu i shoqatës së prodhuesve të qumështit dhe mishit në Kuvend: S’kemi interes të blejmë në Shqipëri, por nga Serbia dhe Bosnja

Edmond Gjata Kryetar i Shoqatës së Prodhimit dhe Përpunimit të Qumështit dhe Mishit, shpreh se TVSH-ja është deformuar dhe ky është një dëm i madh.

“Deformimi i TVSH-së është strumbullari, duhet të marrim masa që të mos kemi largime nga zonat rurale. Nga 6% që ishte tani e çoni 0%, ne u kemi kërkuar të na jepni një shembull, më të mirin për ju dhe më të keqin për ne. Ne nuk kemi interes të blejmë tek

dhe ta shes me 20% TVSH nuk ka shanse. Lënda e parë e jona zë 60% të kostos sonë të prodhimit. Duhet shtruar situata që mos të jetë vonë nesër. Ka rënë numri i fermave dhe i krerëve. Ne propozojmë një grup studimi, merrni një shembull një shtet të huaj dhe e vendosim. Thuhet do jepni subvencion, si do e japësh, unë nuk kam interes ta marr qumështin me letra. Ai që sjell qumështin nga Serbia, ai merr fitimin që atje. Po nuk u rregullua do të ketë një rënie drastike. Nuk ka 289 mijë krerë lope, joo është më pak se gjysma. Skema është problem kombëtar nuk është problem politik”, pohon Edmond Gjata, kryetar i Shoqatës së Prodhimit dhe Përpunimit të Qumështit dhe Mishit.

Eksperti fiskal i KASH në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese: TVSH-ja të shpërndahet në të gjitha hallkat, të bëhen ndryshime tërësore

Agim Binaj kontabilist dhe ekspert fiskal i KASH, i ftuar në Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, shpreh se TVSH-ja duhet të shpërndahet

speriencë në botë ku përjashtohen bizneset me xhiro deri në 10 milionë lekë. ose më jepni një eksperiencë që TVSH është kompensim. TVSH-ja duhet të shpërndahet në të gjitha hallkat. Si mund të paguhet TVSH-ja në doganë kur nuk është taksë doganore, ajo është taksë e tërthorët që i merret konsumatorit. Hiqni dorë nga përjashtimet se prishet cikli, nuk mund ta presësh TVSH-në deri në 10

e shitur mallin. Ne evazionin fiskal e kemi 45%, të paktën kjo është zyrtare por ka edhe të dhëna për 60%, po kush do na e luftoj në këtë? Do e luftojë fatura fiskale ose fiskalizimi që e kemi lënë mes rrugës? Porsa i përket TVSH-në nuk duhet të kalojë ky ligj, ose duhet të bëhen ndryshime tërësore ose mos bëni eksperimente, pasi nuk garanton uljen e evazionit”, u shpreh në Komision Agim

FMN për TVSH, dhe keni të drejtë që TVSH të jetë sa më pak e copëzuar që të kontrollohet më mirë. Për fiskalizimin, synohet ulja e informalitetit. Jo pak herë ka ndodhur që faturat e biznesit kanë qenë fiktive, ajo që bën fiskalizimi është që një faturë nuk lëshohet nga një biznes nëse nuk ka lidhje me NIPT e biznesit tjetër”, shprehet kryetari i Komisionit Arben Pëllumbi.

Në valën e shtrenjtimit të çmimeve dhe shërbimeve në vend, propozimet e fundit të qeverisë në paketën fiskale që prekin sektorin bujqësor do ta rëndojnë edhe më tej situatën.

Ky është paralajmërimi që vjen nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, kur flitet për TVSH 10% që kërkohet të vihet për inputet bujqësore me argument luften kundër informalitetit.

Shoqatat e bizneseve kanë shprehur rezerva të forta sa i përket paketës së re fiskale propozuar nga Ministria e Financave. Sipas tyre, paketa nuk është konsultuar me biznesin, ndërkohë që disa prej ndërhyrjeve rrezikojnë të dëmtojnë kompanitë shqiptare.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar të hënën në Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, Drejtoresha ekzekutive e Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar Enida Shena përmendi pasojat negative dhe dëmin që i shkaktohet sektorit privat, veçanërisht sektorit prodhues nga reduktimi buxhetit dhe taksat, tatimet e tarifës shtesë që

propozohen në Paketën fiskale.

Kreu i Shoqatës së Prodhimit dhe Përpunimit të Qumështit dhe Mishit, tha se TVSH-ja është deformuar dhe kjo do t’i sjellë një dëm të madh biznesit shqiptar, pasi favorizon blerjen jashtë kufijve me çmime më të ulëta, veçanërisht nga Serbia e Bosnje Hercegovina.

Në seancën dëgjimore të së hënës kanë shprehur opinionet e veta Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar KASH; Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë; Shoqata “Industria e Përpunimit të Qumështit”; dhe Shoqata e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike.

Rritja e çmimeve, Kote për ATSH-në: Viojmë subvencionimin e bujqësisë për zbutjen e efekteve

Zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhimo Kote tha për ATSH-në se, politikat subvencionuese dhe investimet që po zbaton qeveria në sektorin e bujqësisë, synojnë të zbusin goditjen e rritjes së çmimeve.

“Qeveria shqiptare subvencionon prodhuesit e produkteve bujqësore, politike që do të vazhdojë edhe për vitet në vijim dhe synon të zgjerohet, me qëllim mbështetjen e prodhuesve në uljen e kostove dhe rritjen e rendimentit”, tha Kote.

Sipas tij, rritja e prodhimit bujqësor në vend, jo vetëm që zhvillon ekonominë dhe

ul papunësinë, por mundëson uljen e çmimeve të produkteve kryesore në tregje, ndërsa theksoi se, në kushtet e ekonomisë së lirë predominon kërkesë oferta që orienton çmimet e tregut.

Kote theksoi se, mbështet-



ja e blegtorisë dhe skema e naftës janë në qendër të vëmendjes.

“Përmes Skemës Kombëtare do të vazhdojmë subvencionimin e blegtorisë dhe të fermerëve që prodhojnë në bujqësi, ndërsa Skema e naftës falas për bujqësinë do të jetë në qendër të vëmendjes dhe do të vijojë paralelisht me mbështetjen financiare të Programit IPARD, që dreson grante për sektorin rural”, u shpreh Kote për ATSH-në.

Ndërsa vuri në dukje gatishmërinë e qeverisë në ndjekjen e këtij problemi dhe adresimin e masave përkatëse.

Gjermani - Shqipëri, bashkëpunim për objektivat e zhvillimit të bujqësisë

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca zhvilloi një takim me ambasadorin e Gjermanisë në Shqipëri, Peter Zingraf.

Ministria Krifca vlerësoi se “Gjermania, si një mbështetëse e aspiratave europiane, është bashkëpunëtor dhe aleat e fortë edhe në bujqësi”.

“Me ambasadorin e Gjermanisë në Shqipëri, Peter Zingraf, morëm angazhim për më tepër bashkëpunim dhe ndërveprim për objektivat e zhvillimit të bujqësisë dhe fshatit”, tha ajo.



Paketa fiskale 2022 heq kompensimin 6% të TVSH-së te prodhuesit, vë taksë për qumështin pluhur; Përpunuesit e qumështit: Ndryshimet janë rrënuese, do rrisin çmimet

(Vijon nga faja 2)

funkcion të realizimit të kontratave do të jetë për investimet me vlerë të barabartë ose më të madhe se 500 milionë lekë nga 50 milionë lekë që është aktualisht.

Reagimi i industrisë

Përfaqësuesi i kompanisë “Erzeni”, z. Sajmir Begaj tha për Monitor se heqja e TVSH-së të rimbursueshme prej 6% do të godasë fort industrinë e cila vuan kostot e shtuara nga ndryshimet e skemës në 2018 (zbatimi nisi nga 1 janari 2019), mungesën e qumështit të prodhuar dhe kostot e larta nga çmimi i energjisë. “Ky është një projektligj rrënues që do të përkeqësojë akoma më shumë situatën në tërësi për industrinë e përpunimit të qumështit. Ndryshimet vijnë në një kohë kur në treg ka mungesë nga 20,000 deri 30,000 litra qumësht. Heqja e TVSH-së jo vetëm do të rrisë kostot e prodhimit, por do të ndikojë edhe te çmimi i produkteve të bulmetit.

Nëse këto ndryshime miratohen përpunuesit e qumështit do të jenë të detyruar të rrisin çmime jo me 5 apo 10% po deri në 30%”, pohon z. Begaj. Më herët Shoqata e Përpunuesve të Qumështit i kishte propozuar Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë ndryshimin në skemën e TVSH-së si në blerje dhe në shitje në nivelet 6 ose 9%.

Për shfuqizimin e heqjes të TVSH-së në blerjet e makinerive me vlerë nga 50 milionë lekë në 500 milionë lekë, z. Sajmir Begaj thotë se do të rrisë kostot e investimeve. “Fabrikat janë të detyruara të investojnë çdo vit në blerje makinerish. Asnjë nuk investon makineri me vlerë 500 milionë lekë. Heqja e TVSH-së të rimbursueshme për investime në blerje makinerish me vlerë deri në 50 milionë lekë do të rrisë automatikisht 20% koston e kredisë për investimin”, pohon Begaj.

Projektligji “Për taksat kombëtare”

Projektligji “Për taksat

kombëtare” vendos taksa qumështin pluhur e importuar në vlerën 100 lekë për kg. Në relacionin e draftit pranohet se prodhimi i qumështit ka pësuar rënie gjatë viteve të fundit dhe ka rritje te produkteve të importit, kryesisht të qumështit pluhur.

“Prodhimi i qumështit në vitin 2020 ka shënuar një rënie me 5,39 %, në krahasim me vitin 2019. Gjithashtu, rënie ka pësuar dhe sasia e qumështit të grumbulluar. Kështu, në vitin 2020, sasia gjithsej e qumështit të grumbulluar rezulton rreth 119 mijë ton nga rreth 140 ton që ishte në vitin 2019, duke pësuar një rënie prej rreth 14,80 %, krahasuar me vitin 2019. Ndërkohë, vihet re një rritje në produktet që importohen për prodhimin e produkteve të bulmetit, ndër të cilët mjaft i rëndësishëm është qumështi pluhur. Kështu, sasia e importuar e këtij produkti për vitin 2020 ka qenë në masën mbi 1.400 ton/vit, sasi kjo rreth 2.5 herë më e lartë kra-

Mbështetje në bujqësi, IPARD II disburson 166 kontrata

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është në proces të vlerësimit dhe disbursimit të fondeve për aplikantët përfitues nga programi IPARD II.

Sipas të dhënave nga AZHBR, aktualisht janë disburuar 166 kontrata investimi të fermerëve dhe biznesit, që janë kryer në sektorin e bujqësisë e agropërpunimit, të cilët përfi-

tojnë financim grant nga zbatimi i programit IPARD II në Shqipëri.

Investimet në kuadër të Programit IPARD II, kanë mundësi të shndërrojnë totalisht të gjithë infrastrukturën bujqësore në vend në aspektin e zhvillimit të agropërpunimit, diversifikimit të fermës dhe investimeve në fermë, me impakt rritjen e ka-

paciteteve prodhuese në vend, për sektorët e fruta-perimeve, blegtorisë, qumështit, mishit, vreshtarisë dhe të verës.

Programi IPARD II në total ka një fond prej 90 milionë euro. AZHBR ka çelur tri thirrje aplikimi për fermerët dhe agrobiznesin në disbursimin e fondeve në mbështetje të investimeve në bujqësi.

Korçë, 100 studentë dhe fermerë të rinj angazhohen për startup-et në bujqësi

Digjitalizimi i bujqësisë është një ndër faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm dhe inovacionin në këtë sektor.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës, me mbështetjen e Qeverisë Gjermane, nisin zbatimin e një programi të ri, që ka për qëllim të bashkojë 100 studentë të bujqësisë, fermerë të rinj në rajonin e Korçës, për të gjeneruar dhe zbatuar ide të reja në fushën e Startup-e.

“AgriChallenge mirëpret dhe programuesit e rinj, apo freelancers, për të krijuar një rrjet të një komuniteti me aftësi të përziera siç janë aftësitë e shekullit 21, të cilët mund të përfitojnë nga projektet e ardhshme të mbështetura nga donatorët”, bën të ditur MBZHR.

Sipas MBZHR, përmes digjitalizimit të bujqësisë syno-

het të shkohet drejt çdo burimi informacioni që kemi në lidhje me bujqësinë, duke adresuar

Bujqësore. Kjo për faktin se, gjithnjë e më shumë po synohet që prodhimi bujqësor vendas të



nevoja bazë që i shërbejnë gjithë komunitetit.

Vitet e fundit fermerët kanë shtuar kërkesat për informacion në fushën e inovacionit dhe start-up pranë Qendrave të Transferimit të Teknologjisë

orientohet drejt eksporteve.

Ndaj dhe programi i ri synon të nxisë startup-et në sektorin e bujqësisë, për rajonin e Korçës që spikat për potenciale të larta të prodhimit dhe eksportit bujqësor.

Brenda 2022-shit krijohet regjistri i fermave

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit rural, Frida Krifca deklaroi se brenda vitit 2022 do të përfundojë i gjithë procesi i regjistrimit të fermave në të gjithë vendin.

Gjatë diskutimit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave të projektbuxhetit për vitin 2022, ministria theksoi ky është një

për të ndërtuar infrastrukturën për regjistrin e fermës. Pjesën tjetër e kemi buxhetuar me buxhetin e vitit 2022. Me shumë entuziazëm ju them se regjistri i fermës do jetë kapitull i mbyllur brenda vitit 2022. E kemi detyrim ndaj Komisionit Evropian për akreditimin e programit IPARD 3 që e kemi detyrim



detyrim ndaj Komisionit Evropian dhe detyrim në politikëbërje, në mënyrë që Ministria të dijë kujt t’i adresohet kur ndërton politikat.

“Kam nxjerr një urdhrë më 11 tetor për të inventarizuar. Kemi miratuar një metodologji,

në fillim të vitit që vjen. Jo vetëm për këtë. E kemi detyrim edhe në politikëbërje dhe qasjes që duam ne si Ministri, në mënyrë që të dimë kujt t’i adresohemi kur ndërtojmë politikat tona. Ka filluar puna”, tha Krifca.

AKUAKULTURË

Investime në akuakulturë, lehtësohen procedurat e prokurimit

Me propozim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, qeveria miratoi sot dy ndryshime të rëndësishme, në VKM ekzistuese, që kanë të bëjnë me sektorin e akuakulturës dhe sigurisë ushqimore.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca tha se “ndryshimi i parë ka të

kemi gjetur akuakulturën me 1500 tonë prodhim dhe eksporte dhe e kemi çuar deri në 9000 tonë sot, dhe kemi objektiv ta dyfishojmë këtë shifër dhe të njëjtën gjë duam të bëjmë edhe me peshkimin, ku i kemi çuar eksportet në 14 mijë tonë dhe do ta dyfishojmë edhe këtë tregues”.



bëjë me vendimin për standardizimin e prokurimeve për akuakulturën dhe peshkimin”, e cila na sjell një proces shumë më të standardizuar, por edhe të thjeshtuar, për të krijuar gjithë hapësirën e mundshme administrative, me qëllim që të shkojmë me peshkimin dhe akuakulturën në atë vizion që kemi, për të pasur një ndikim real në ekonominë e vendit, nëpërmjet eksportit”.

Krifca theksoi se, “ne e

“Duke mbështetur sektorin e peshkimit dhe akuakulturën, jemi duke identifikuar të gjithë nevojat që ka ky sektor, duke synuar të përmirësojmë edhe flotën e peshkimit dhe investuar në të gjithë kapacitet e këtij sektori”, tha ministria.

Duke u ndalur tek vendimi i dytë që miratoi sot qeveria, Krifca tha se “ajo ka të bëjë në thelb me sigurinë ushqimore, që ka sensibilitet të madh për prodhuesit dhe konsumatorin”.

“VKM ka të bëjë me çregjistrimin e Produkteve të Mbrojtjes Bimore dhe afateve përkatëse, çka do të thotë që nëse kemi patur një produkt që alertohej dhe duhej të hiqej nga tregu, aktualisht duhej të respektoje afatin e skadencës së produktit. Ndërsa tani kemi mundësinë që të reagojmë shumë më shpejt dhe maksimumi me një afat 6-mujor, në momentin që për to sinjalizohen në sisteme dhe të mund të kryejmë kontrollet e duhura dhe të asgjësojmë stokun e mundshëm në të gjitha pikat ku këto shiten”, deklaroi ajo.

Gjithashtu vuri në dukje Krifca, “do të lehtësojmë dhe shtojmë sigurinë ushqimore, duke e bërë më transparente ndaj publikut të gjithë procedurën e aplikimit të kompanive që prodhojnë apo importojnë Produkte të Mbrojtjes së Bimëve. Nëpërmjet portalit e-Albania, online të gjithë kanë mundësi, fermerët dhe sipërmarrjet të njihen me listën e Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve të aprovuar nga MB-ZHR”.

“Ndërkohë kemi krijuar komisionin e monitorimit për këtë proces, që ka të drejtë të kërkojë dhe kontrollojë në detaje, listën e Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve”, tha Krifca.

- Kooperativistja që u bë biznesmene - Historia e eksportueses së madhe që e nisi biznesin duke shitur domate në rrugë

Historia e Nedrete Arapi do të na tregojë që nuk është kurrë vonë për të ndryshuar fatin e jetës. Nedrete nuk ka shkuar në shkollë të lartë, nuk është rritur në qytet.

Jeta e fshatit I mësoi bujqësinë. Toka e ka bërë atë eksportuesen më të fuqishme në Shqipëri. Në vitin 1990, Antoneta ishte 38, në ato vite të rinjtë emigronin, ndërsa Nedretja vendosi të ngreje serat e para të domates në Lushnje.

Pa makinë, pa ndihmën e askujt doli të shesë domate në rrugë, kërkesat e mëdha për perime e shtynë Nedreten të shtojë sipërfaqen e të mbjelave, i gjithë prodhimi shitej brenda natës në tregun agro ushqimor të Lushnjes. Ndërsa sot për Sadeten punojnë 3000 fermerë. Prodhimet bujqësore shqiptare, i shet në tregjet europiane.

Nedrete Arapi, EKSPOR-TUESE: “Unë thjesht kam qenë një kooperativiste. Mbas ktheu sistemi në vitet 1990 si të gjithë shqiptarët dikush rendi pas emigrimit e dikush pas tregtisë, ndërsa unë

ika pas bujqësisë. Si fillim ngrita 5 dynym sera me para borxh. Ato vite kur nuk kishte shumë sera Shqipëria produktet tonë kërkoreshin, si fillim u mbush tregu vendas nga

tregtarin unë eca disa hapa përpera të tjerëve.”

Sot nga pika e grumbullimit e Nedretes dhjetra kamione me perime nisen drejt Europës. Pas kësaj histori



prodhimi madh produktet filuan të hidheshin mua aty më lindi idea për tregti. Fillova të shisja në rrugë me kilogra më pas u futa në tregun e Lushnjes. Aty rastësisht takova dy eksportues nga Kosova dhe Mali i Zi, ramë në ujdj dhe filluam eksportin. Si fillim me një kamion më pas me dy dhe duke njohur prodhuesin dhe

suksesi, mbrapa qendron dhe sakrificat dhe netë të tjerë pa gjumë.

ANTONETA, EKSPOR-TUESE: “Nga 1998-2007 kanë qenë vitet e mia më të lodhshme unë flija vetëm dy orë gjumë në makinë. Në darke shisja në tregun e Lushnjes ndërsa ditë shkoja punoja serat. “

Finiq, edukimi mjedisor në shkolla, “thembra e Akilit” për çështjet e ndotjes nga plastika

Edukimi mjedisor në shkolla për çështjet e ndotjes nga plastika. Ky ishte fokusi i tryezës mediatike organizuar së fundi në Finiq, nga qendra Agjencia AJMMI dhe program GIZ (Bashkëpunimi Ekonomik nderkombëtar) në kuadër të Projektit “Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve & Parandalimi i Mbetjeve Detare në Ballkanin Perëndimor”, zbatuar në Bashkinë Finiq

mbeturinave urbane dhe 100 kontainerë për menaxhim më të mirë të mbetjeve, por duke përfutur edhe metodologjinë për një mjedis sa më të pastër në kuadër edhe të me strategjinë për t'i dhënë një drejtim turistik kësaj zone.”

Kjo fazë përkon pas takimit me Kryeministrin, duke u dhënë një drejtim tjetër gjithë problematikave të pastrimit. Për Qarkun Vlorë muaji nëntor do të jetë një muaj i për-

cakimit të zonave të nxehta dhe i zgjerimit me zonat që ne pastrojmë, megjithë territorin mjaft të gjerë me 58 fshatra, terrenin malor të bashkisë në disa zona etj...-tha Kiço.

“Duke përmendur rolin e shkollave në edukimin mjedisor, kreu i, Bashkisë Finiq i ka konsideruar “Thembrën e Akilit”, shkollat ku fëmijët marrin edukimin mjedisor dhe të punojmë për ndarjen e mbetjeve që në burim”, vuri

në dukje Kiço.

Gavrosh Zela, koordinatori shqiptar i projektit GIZ, përmendi se projekti që nisi në prill 2018. Si projekt rajonal që përfshin Shqipërinë, Malin e Zi dhe Bosnjë Hercegovinën, vazhdon deri në mars 2022.

“Bashkia Finiq, vuri në dukje Zela, është një bashki shumë aktive partnere”. Ai nënvizoi faktin e rritjes së sipërfaqeve të shërbimit të pastrimit me 30 për qind.

“Duke u fokusuar te edukimi mjedisor në shkolla, kemi mundësi të parandalojmë ndotjen, po edhe si t'i edukojmë fëmijët në shkolla për të zvogëluar sasinë e artikuljeve plastike në përdorim me alternativa të tjera” -tha Zela.

Për këshilltaren pranë Projektit, GIZ Yllka Sela: “Jemi përpjekur që t'i mësojmë fokusimit të pjesa e edukimit me nxënësit e shkollave dhe këtë e kemi bërë si

me mbështetjen e AJMMI-t në Sarandë ashtu edhe të Milieukontakt në bashkinë e Lezhës.”

Përfaqësues të Qendrës AJMMI sollën shembuj mbi ecurinë e aktivitetëve më shkollat për edukimin mjedisor, duke veçuar aksionet e pastrimit në terren të basenit të lumit Bistrica, në konkurset me artikuj riciklues të mbetjeve plastike, me konkurset artistike, këndet mjedisore nëpër shkollat e Bashkisë Finiq si dhe në krijimin e skuadrave të vullnetarëve mjedisorë.

Bashkia e Finiqit është e dyta bashki në Shqipëri, krahas asaj të Lezhës që është përzgjedhur 3 vite më parë nga Projekti GIZ për implementimin e projektit “Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve & pakësimi i plastikës”.



OPED - DITA BOTËRORE E USHQIMIT 2021

Një moment i ri për transformimin e sistemeve agro-ushqimore dhe dhënies fund urisë

Nga QU Dongyu, Drejtor i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë

Një Forum Risi Botëror i Ushqimit u mblodh me sukses

zhvillim, ofrojnë një potencial të pakufizuar.



QU Dongyu, Drejtor i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë

në Romë në fillim të këtij muaji, i mundur nga rinia globale dhe përfaqësuesit e të rinjve të FAO-s dhe agjencive tona simotra, me fokus qasjen e brezave të rinj. Ata janë më shumë në rrezik, sepse do të jetojnë me pasojat e drejtpërdrejta të krizës klimatike dhe mosfunksionimit të sistemeve agro-ushqimore. Në të njëjtën kohë, 1.8 miliardë të rinj në botë sot midis moshës 10 dhe 24 vjeç, nga të cilët gati 90 përqind që jetojnë në vendet në

Ne tashmë kemi filluar ta sensibilizojmë të gjithë me ndërgjegjësim, zgjidhjet holistike dhe veprimet konkrete të drejtuara nga të rinjtë dhe që kërkojnë ndryshim. Sigurisht të rinjtë nuk janë të vetmit që duhet të shqetësohen për sistemet tona agro-ushqimore, të cilat nuk janë të përshtatshme, dhe se si t'i bëjnë ato më efikase, gjithëpërfshirëse, elastike dhe të qëndrueshme.

Edhe para se COVID-19 të ishte në qendër të vëmendjes

sonë për cënueshmërinë e sistemeve agro-ushqimore në botë, qindra miliona njerëz në mbarë botën janë prekur nga uria dhe ky numër është rritur vitin e fundit deri në 811 milion. Pavarësisht se bota prodhon ushqim të mjaftueshëm për të gjithë ne, kjo është e paimagjinueshme dhe e papranueshme.

Në të njëjtën kohë, 14 përqind e ushqimit që prodhojmë humbet dhe 17 përqind tjetër. Kombinuar kjo me shkaqe të tjera, si dëmtuesit dhe sëmundjet, fatkeqësitë natyrore, humbjen e biodiversitetit dhe shkatërrimin e habitatit dhe konfliktet, ju mund të shihni magnitudën e sfidës me të cilën përballemi për përmbushjen e nevojave në rritje të ushqimit në botë, duke zvogëluar njëkohësisht ndikimet e ndryshimeve klimatike tek sistemet tona agro-ushqimore.

FAO, si agjencia kryesore që punon në ushqim dhe bujqësi, ka zhvilluar një sërë metodash, për të cilën ne jemi të sigurt se mund të na mundësojnë të ketë një ndikim më shumë nga këto probleme komplekse dhe sistematike.

Ne kemi kuptuar qartë se ku

po shkojmë, kemi përshtatur objektivat: Prodhim më i Mirë, Ushqim më i Mirë, Mjedis më i Mirë dhe Jetë më e Mirë. Dhe puna jonë mbështetet nga një Kornizë e re Strategjike 2022-2031 për dhjetë vitet e ardhshme që përcakton veprimet dhe kontributet konkrete të nevojshme për t'i bërë Katër Më të Mirat realitet, duke mos lënë askënd pas.

FAO vlerëson se rreth 40 deri në 50 miliardë dollarë investime vjetore në ndërhyrjet e synuara janë të nevojshme për t'i dhënë fund urisë deri në vitin 2030. Ka shumë projekte me kosto të ulët, me ndikim të lartë që mund të ndihmojnë qindra miliona njerëz të plotësojnë më mirë nevojat e tyre ushqimore.

Për shembull, ndërhyrjet e synuara mbi Kërkimin dhe Zhvillimin për ta bërë bujqësinë më të avancuar në teknologji, inovacioni në bujqësinë dixhitale dhe për të përmirësuar nivelin e edukimit në mesin e grave, gjë që mund të çojë në uljen e urisë. Por ka edhe elementë të tjerë thelbësorë si të dhëna më të mira, qeverisje dhe institucione më të mira.

Për më tepër, qasja jonë mund të jetë efektive vetëm nëse është

e rrënjësor në punën me qeveritë dhe partnerët kryesorë, pasi ato krijojnë strategjitë e tyre kombëtare drejt transformimit në përputhje me kushtet dhe nevojat e tyre specifike.

Ne gjithashtu duhet të kuptojmë se shkencëtarët dhe burokratët, madje edhe prodhuesit dhe shpërndarësit e ushqimit nuk do të jenë kurrë në gjendje të sjellin vetë të gjitha këto ndryshime të nevojshme.

Transformimi mund dhe duhet të fillojë me veprime pragmatike dhe konkrete nga konsumatorët e zakonshëm dhe zgjedhjet që bëjmë. Vendimet që marrim çdo ditë për ushqimet që konsumojmë, ku i blejmë, si paketohen, sa ushqim hedhim, të gjitha këto kanë ndikim në sistemet tona agro-ushqimore dhe të ardhmen e këtij planeti.

Të gjithë ne kemi potencialin për të qenë heronj të ushqimit. Veprimet tona janë e ardhmja jonë. Procesi i transformimit të sistemeve tona agro-ushqimore dhe ndikimi që ato kanë në luftën ndaj urisë globale, cilësia e ushqyerjes, dietat e shëndetshme, miqësor me mjedisin, dhe menaxhimin e mbetjeve, kjo fillon me ju dhe mua.

Por nuk mbaron me ty dhe mua. Fjala e urtë thotë: "Ne jemi çfarë konsumojmë". Është gjithashtu e vërtetë se mënyra se si zhvillohen fëmijët dhe nipërit tanë do të ndikohet gjithashtu nga ajo se si ne ushqehemi. Shpresa është në duart e tyre për të vazhduar. Le të mësojmë së bashku, të punojmë së bashku dhe të kontribuojmë së bashku.

Dita Botërore e Ushqimit, FAO apelon për transformimin e sistemeve agro-ushqimore

Të Premten më 15 Tetor, në celebrimin e Ditës Botërore të Ushqimit 2021, Drejtori i Përgjithshëm i FAO, QU Dongyu, së bashku me krerët e Agjencive të tjera të OKB-së me bazë në Romë, David M. Beasley, Drejtor Ekzekutiv i Programi Botëror të Ushqimit (WFP) dhe Gilbert F. Houngbo, President, Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD), nisën zyrtarisht festimet e këtij viti me një ngjarje hibride tëmbajtur në Romë.

Drejtori i Përgjithshëm i FAO, QU Dongyu gjatë fjalës së tij theksoi se: "Dita Botërore e Ushqimit e këtij viti na gjen në një moment kritik. Pandemia e COVID-19 mbetet një sfidë globale, duke shkak-

tuar humbje dhe vështirësi të panumërta. Ndikimet e krizës klimatike janë rreth nesh. Jeta të panumërta janë hedhur në trazira. Mendimet tona janë bashkë me njerëzit në Afganistan, Haiti dhe shumë emergjencat të tjera humanitare".

Ai shtoi se sfidat globale të sigurisë ushqimore nuk kanë qenë kaq të rënda për vite me

radhë. "Megjithatë, vitin e kaluar ne kemi qenë dëshmitarë të elasticitetit dhe fuqisë brenda të gjithëve ne. Korniza jonë e re Strategjike 2022-2031, e miratuar nga 194 Anëtarët e FAO-s, mbështet Axhendën 2030 përmes transformimit në sisteme agro-ushqimore më efikase, gjithëpërfshirëse, elastike dhe të qëndrueshme, për

prodhim më të Mirë, Ushqim më të Mirë, Mjedis më të Mirë dhe Jetë më të Mirë", u shpreh QU Dongyu.

Ceremonia përmbajti mesazhe speciale nga Papa Françesku, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së António Guterres dhe Presidenti Italian Sergio Mattarella. Aktivitete të ndryshme do të mbahen në 150 vende anembanë botës për të shënuar Ditën Botërore të Ushqimit, duke e bërë atë një nga ditët më të festuara ndërkombëtare të vitit që do të shfaqen në Expo Dubai, si aktivitete dhe ngjarje që kërkojnë solidaritet global në rimendimin dhe riformimin e sistemeve tona ushqimore.

Tema e Ditës Botërore të Ushqimit të këtij viti, "Veprimet tona janë e ardhmja jonë", u bën thirrje të gjithëve të jenë një hero ushqimi që kontribuon në transformimin e sistemeve agro-ushqimore për Prodhim më të Mirë, Ushqim më të Mirë, Mjedis më të Mirë dhe Jetë më të Mirë, duke lënë askënd prapa. Për të dytin vit radhazi, celebrohen heronjtë e ushqimit, përmes një fushate në shumë platforma që i njeh me fermerët, prodhuesit dhe tjerët, ata që sigurojnë ushqim komuniteteve, duke ndihmuar në rritjen, ushqimin dhe mbajtjen e botës sonë.

Dita Botërore e Ushqimit festohet çdo vit më 16 tetor, për të përkujtuar themelimin e FAO në atë ditë në 1945.



RISI ALBANIA

Punësimi i të rinjve - Turizmi dhe Agrobiznesi sektor potencial

Projekti Zviceran për punësimin e të rinjve, RisiAlbania adreson papunësinë e të rinjve në Shqipëri që nga viti 2013

“

Adrian Maître,**Ambasador i Zvicrës në Shqipëri:**

Teksa Shqipëria përgatitet për tregun evropian, vendosja e standardeve është moment kyç. Standardet ndërkombëtare janë kyçe për turizmin, përfshirë ruajtjen e mjedisit. Standardet janë thelbësore për të mbajtur vizitorët. Mungesa e punonjësve të kualifikuar është sfidë. Nëse ka një element që garanton sukses është koordinimi i mirë mes faktorit publik dhe sektorit privat.

sues të institucioneve publike dhe private në Shqipëri.

“Teksa Shqipëria përgatitet për tregun evropian, vendosja e standardeve është moment kyç. Standardet ndërkombëtare janë kyçe për turizmin, përfshirë ruajtjen e mjedisit. Standardet janë thelbësore për të mbajtur vizitorët. Mungesa e punonjësve të kualifikuar është sfidë. Nëse ka një element që garanton sukses është koordinimi i mirë mes faktorit publik dhe sektorit privat”- tha Adrian

Maître Ambasador i Zvicrës në Shqipëri.

Znj. Mirela Kumbaro, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit vlerësoi pozitivisht modelin si Visit-Gjirokastra dhe theksoi se turizmi është një mënyrë e mirë për të rritur punësimin, ndërsa njoftoi zgjerimin nga 18 në 23% të zonave të mbrojtura, përfshirë edhe Luginën e Vjosës.

Paneli i dytë u fokusua në eksperiencat e partnerëve të Risisë, si dhe të rinjve. Përgjatë

këtyre 8 viteve, RisiAlbania ka punuar me pothuajse 80 institucione publike dhe private në Shqipëri për të prezantuar mënyra inovatore dhe të qëndrueshme të bërjes së biznesit, si e vetmja mënyrë për të krijuar vende të reja dhe të qëndrueshme pune për të rinjtë.

RisiAlbania punon për të krijuar më shumë mundësi punësimi dhe mundësi sa më të mira duke u fokusuar në 3 drejtime kryesore: zhvillimi i sektorit privat në Shqipëri, prezantimi dhe përmirësimi i shërbimeve të orientimit në karrierë dhe ndërmjetësimit, si dhe zhvillimin e aftësive në përpunje me tregun, për të përmbushur kërkesat e bizneseve.



Sot po diskutohet për rritjen e normës së inflacionit, për rritjen e çmimit të bukës, të qirave, të transportit etj, etj. Shumë mirë bëhet, sidomos me rritjen e çmimit të bukës, që është ushqimi bazë për shumicën e shqiptarëve. Arsyet që jepen për këtë rritje të ndjeshme shpjegohen me faktorë egzogjen, shpjegohen me rritjen e çmimeve në bursa, pra nuk shikohet dhe analizohet

Ekonomia e qëndrueshme arrihet me prodhim-eksport, jo me konsum-import

Analizë nga Prof. Dr. Alqi Naqellari: Qeveritarët dhe institucionet nuk duhet ta shikojnë rritjen e çmimeve në funksion të pagës së sa të ndryshimit të kostos. Kur u rrit çmimi i ujit, “hë mo, u tha, se nuk zë ndonji peshë të madhe në page”. E njëjta gjë edhe me energjinë, me transportin, me ushqimet dhe tani edhe me bukën.



situata në vend, por burimi i rritjes së tyre shihet jashtë Shqipërisë. Kjo nuk ndodh vetëm për bukën, por edhe për gjithë ushqimet e tjera. Kjo ndodh edhe për vajin, për sheqerin, për orizin, kafënë, kakaon etj, sepse Shqipëria është një vend

që importon shumë dhe eksporton shumë pak. Është një vend që qeveritë kanë synuar ta kthejnë në një ekonomi shërbimi dhe jo prodhimi, ta kthejnë në një vend me prioritet turizmin, pa e ditur konceptin e tij, duke e konceptuar si tregti

me pakicë, si hotele e motele në bregdet dhe hane e bujtina në ca fshatra të largëta. E kanë konceptuar si rritje të bujqësisë nën këndvështrimin e tyre, aspak kompetent, por thjesht amator dhe fluturak. Nëse qeveria e PD-së premtoi dhe u zotua se do mbillte një 5 milionë rrënjë ullinj, arrorë e farorë, PS premtoi jo vonë, por para një jave se do synojë të shtojë blegtorinë e imët me 2 milionë krerë. PD dështoi me turp në këtë premtime dhe askush nuk mbajti përgjegjësi! Pasoja ranë mbi popullin. Edhe PS do dështojë, se nuk mund të shtohen 2 milion të imta edhe teorikisht dhe jo më praktikisht se të imtat janë genie të gjalla, me cikël biologjik dhe nuk janë

tulla e tjegulla, të shtypim sustën dhe t'i shtojmë. Aq më keq në një ekonomi bujqësore siç është Shqipëria, ku ka mbi një



milion parcela toke, ku Ligji 7501 i bëri gjëmën ekonomisë

shqiptare. Kështu, shkurt fare, kjo situatë ekonomike me pasojë papunësinë, inflacionin, emigracionin, shpopullimin

e fshatrave dhe përqendrimin në zona të zhvilluara shpjego-

het kryesisht prej faktorëve të brendshëm dhe jo prej faktorëve të jashtëm, shpjegohet prej politikave ekonomike të gabuara të qeverive shqiptare, prej qëndrimit të tyre ndaj korrupsionit, ndaj nepotizmit, ndaj tregut, ndaj konkurrencës dhe ndaj popullit. Vetëm një ekonomi e bazuar në prodhim-eksport i mban treguesit makroekonomik të qëndrueshëm dhe jo një ekonomi shërbimi dhe importi. Ekonomitë me bazë shërbimin dhe importin janë absolutisht të paqëndrueshme, sepse ato reagojnë negativisht ndaj çdo veprimi në ambientin ekonomik e politik të jashtëm, ato reagojnë negativisht ndaj çdo fenomeni objektiv që ndikon mbi ekonominë, ato reagojnë ndaj konflikteve midis vendeve, ndaj pandemive dhe sëmundjeve të ndryshme, ndaj fenomeneve natyrore etj. Mungesën e qëndrueshmërisë së tyre e kanë provuar vendet që e kanë një ekonomi të tillë si Greqia, Spanja etj., e provoi vetë ekonomia shqiptare në periudhën e Covid-19. Më poshtë do



TASE GROUP

Adresa: Rruga e Kavajës, Qendra Kondor (ish parku i autobuzave, poshtë "21 Dhjetorit"), Tiranë
Tel: 0035542239968; Fax/Tel: 0035542220027; e-mail: info@tasegroup.al;
Website: www.tasegroup.al; Celular: 0684855580 (Kushineta, Premistopa dhe rripa)
Celular: 0672035581 (Pjesë këmbimi për traktorë)



Ofrojmë:

- PJESE MOTORIKE
- FREKSIONE
- PERMISTOPA
- KUSHINETA
- RRIPIA
- AKSE
- PJESE ELEKTRIKE
- PJESE HIDRAULIKE
- VAJRA DHE FILTRA



KASH

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë



FED
invest 


**GJITHMONË
FINANCË SOCIALE**

(Vijon nga faqja 7)

shikojmë se çfarë është inflacioni, nga se shkaktohet dhe si zbuten efektet e tij negative.

Çfarë është inflacioni, nga se shkaktohet dhe si zbutet?

Me inflacion kuptojmë një rënie të fuqisë blerëse të parasë, domethënë nëse me 100 lekë dje blija një bukë, sot më duhen 120 lekë. Inflacioni llogaritet mbi 12 grupe mallrash ose mbi 331 lloje të mirash dhe shërbimesh. Pra nuk merren të gjitha mallrat dhe shërbimet që prodhohen në Shqipëri, por një pjesë e tyre pavarësisht se janë prodhime vendi apo të importit. Nëse marrim vetëm prodhimet e vendit kemi deflator të PBB-së, i cili në Shqipëri ka shumë ndryshim me inflacionin. Zëri kryesor në grupet që llogaritet IÇK (Indeksi Çmimeve të Konsumit) është Ushqime dhe pije jo alkoolike. Ky zëri në strukturën e mallrave është llogaritur të jetë 32.1. Shuma e 12 grupeve jep 100. Për mendimin tim kjo pjesë, por e quaj përqindje, është e gabuar. Ajo ka variuar nga 72% në 48% dhe 41%. Sipas INSTAT sot është 32.1. Pse? Çfarë ndryshoi? Në një kohë që numri i pensionistëve dhe me arsye të tjera që marrin transfertë pagesash po arrijn në 800 mijë kur mbi 300 mijë marrim përkrahje sociale? Arsyeja e thjeshtë është që norma reale e inflacionit të fshihet nëpërmjet treguesve të tjerë që nuk kanë ndonjë peshë të dukshme në konsumin e qytetarëve të theshtë, të shtresës me të ardhura mesatare dhe me të ardhura të ulëta. Nëse do përcaktohej inflacioni duke marrë në konsideratë edhe strukturën e popullsisë atëherë pa frikë do jepte një shifër të frikshme. Pensionistët dhe grupet e tjera të marxhinalizuara shpenzojnë më shumë se 70% të të ardhurave për ushqime dhe medikamente.



Inflacioni sipas modelit Keynesian AD-AS (Kërkesë-ofertës agregate) shkaktohet në këto raste:

1-Kur rritet kërkesa agregate më shumë se oferta agregate. Pasoja janë rritje e nivelit agregat të çmimeve, rritje e prodhimit dhe ulje të normës së papunësisë. A ka ndodhur kjo në Shqipëri? Jo.

Nuk ka ndodhur, sepse nuk është rritur kërkesa. Nuk mund të rritet kërkesa në një vend që për çdo vit largohen me mijra të rinj e të reja, forcë e aftë për punë dhe konsumator aktiv. Në një vend ku pensionistët shtohen me 20-30 mijë çdo vit.

2-Kur ulet oferta agregate. Supozon faktin që të ulet prodhimi vendas pa ndryshuar kërkesën. Ka ndodhur kjo në Shqipëri? Jo. Sepse thuajse të gjitha mallrat që shiten në treg i kanë çmimet e përcaktuara nga importet, që nga drithërat e deri tek karburantet. Që një mall ta përcaktojë çmimin nga prodhimi i brendshëm duhet që të paktën ai të realizohet dhe tregëtohet në vend mbi 50%. Po cilin mall prodhojmë dhe shesim në mënyrë që çmimi i importeve t'i nënështrohet çmimit të vendit? Asnjë, as grurin e as karburantet. Çmimet e tyre përcaktohen nga importet. Thuhet se 48% e nevojave për grurë sigurohen në vend (B.Çuçi, ish Ministër i Bujqësisë). Pra prodhohen rreth 240 mijë ton grurë. Unë dyshoj në këtë shifër, sepse ne kemi importe 240 mijë ton, atëherë i takon që në Shqipëri të konsumohen 480 mijë ton grurë. Me një popullsi 2.5 milion njerëz i bie që norma për frymë të jetë 192 kg, gjë që është e pamundur. Norma e konsumit llogaritet para viteve 90, kur baza e ushqimeve ishte buka, me 180 kg/frymë për popullsinë e rritur. Po nga e siguron Shqipëria 240 mijë ton grurë? Shqipëria mbjell 53 mijë e 946 hektar me grurë dhe 56 mijë e 727 hektar me misër(2020), prodhon 233 mijë e 430 ton grurë dhe 399 mijë e 125 ton misër, pra 43 kv ha grurë dhe 70.3 kv ha misër. A janë të vërteta këto shifra? Për mendimin tim dhe kolegëve të mij, që kemi punuar në kooperativa bujqësore, “Jo”. Si mund të

edhe për grurin. Rendimenti 40kv/ha merrej në parcelat më të mira duke i trajtuar me plehra kimike, me shërbime deri në ujti. A mund të merret sot një rendiment i tillë në kushtet e bujqësisë shqiptare? Bujqësia shqiptare nuk mund të krahasohet me asnjë vend të Ballkanit, sepse ka bërë reformën agrare, e cila ka dhënë pasoja katastrofike për prodhimin. Në Shqipëri ka rreth 350 mijë fermerë, toka e të cilëve është e parcelizuar në mbi 1 milion parcela. Një parcelim i tillë nuk lejon përdorimin në shkallë të gjerë të mekanikës, në përqendrimin e prodhimit. Secili prodhon produktet, që i nevojiten për të jetuar, vetëm 60 mijë prej tyre kanë NIPT. Ka vetëm 12 mijë traktorë me goma dhe mjete të tjera që i shërbejnë kultivimit të bimëve bujqësore. Mungon sistemi i kanaleve kulluese e ujitëse. Nëse do sigurohej ky prodhim (233 mijë ton grurë dhe 399 mijë ton misër) atëherë nuk do kishte shumë problem me çmimin e grurit, sepse prodhimi vendas së bashku edhe me përdorimin e bukës së misrit do mbulonte një pjesë të mirë të nevojave të shqiptarëve. Kjo do ishte edhe më e sigurtë nëse prodhuesit e miellit dhe shteti do mbanin në magazinat e tyre edhe rezervat siç i mbajnë vendet e tjera.



3-Rritja e çmimeve të importit të drithrave. Inflacioni në Shqipëri është përgjithësisht i importuar. Shqipëria importon prej Serbisë, e cila zë gati 30% të importeve dhe Ruisë që zë rreth 60%. Vendet kryesore eksportuese në botë janë:

Eksportuesit kryesorë të grurit, miliona tonë

Burimi: FAOSTAT (2021)

Po analizojmë Serbinë meqënëse flitet shumë për Ballkanin e Hapur

Serbia. Në vitet e fundit është bërë partner kryesor në importimin e grurit. Ka qenë partner kryesor Rusia me rreth 70% të importeve, por sot kanë ndryshuar raportet rrënjësisht. Serbia, është eksportuesi i shtatë më i madh në botë i misrit. Në vitin 2020, Serbia u rendit e 23-ta me pjesëmarrjen në eksport.


Në vitin 2020, Serbia u rendit në vendin e 142-të me pjesëmarrjen në import prej ≈ 0.0%.

Në vitin 2019, Serbia u rendit e 36-ta me pjesëmarrjen në prodhim.

Serbia është bashkuar me vendet kryesore eksportuese dhe importuese të grurit në Këshillin Ndërkombëtar të Drithërave. Nga një raport i lëshuar nga një atashe i Departamentit Amerikan të Bujqësisë në Beograd, sipërfaqja e përgjithshme e grurit të Serbisë vlerësohet në 600,000 ha, 5 përqind më e lartë se në vitin e kaluar kryesisht për shkak të çmimeve të larta të grurit gjatë MY2019/20. Vlerësimet përfundimtare zyrtare të kulturës së grurit MY2020/21 vënë sipërfaqen e përgjithshme të grurit të korrur në 570,000 HA, prodhimi i përgjithshëm i grurit vlerësohet në 2.6 milion MT dhe vlerësoi një rendiment mesatar të grurit në 4.6 MT/HA. Rezervat e larta nga MY2019/20 prej 1 milion MT dhe MY2020/21 prej 2.6 milion MT, do të sigurojnë grurë të mjaftueshëm për konsum të brendshëm dhe rreth 1.2 milion MT për eksport.

Thatësira në Rumani, Ukrainë dhe Hungari uli furnizimin me grurë në rajonin e Detit të Zi dhe kështu ndikoi në rritjen e çmimit. Çmimi i grurit u rrit nga 17 dinarë/kg (\$ 170/MT) në korrik në çmimin aktual prej 22.5 dinarë/kg (\$ 225/MT). 40 përqind e grurit është eksportohet me rrugë tokësore në vendet fqinje. Në 21/20 në Serbi ishte kjo shpërndarje. Prodhim(2.6ml/T)+ stok në ton = 3526000. Nga kjo zbriten 1800000 (konsum), 1300000 (eksport) dhe 426000 (veprime të fundit). Kështu Serbia eksporton jo më pak se 1.3 milion tonë. Në vitin 2021, diapazoni i përafërt i çmimeve për Serbinë e miellit të grurit është midis 0.29 \$ dhe 0.25 \$ për kilogram ose midis \$ 0.13 dhe 0.11 \$ për paund (lb). Çmimi në dinarin serb është 27.93 RSD për kg. Çmimi mesatar për një ton është 285.39 dollarë amerikanë në Novi Sad dhe Beograd. Në Serbi nuk ka ndonjë rritje të çmimit të bukës. Serbët kanë rritur çmimet e eksportit, por gjithsesi nëse i krahasojmë me çmimet në Shqipëri ato mbeten shumë më favorizuese. 22.5dinarë/kg = 225\$/ton ose 0.225 \$ kg x 103.5= 23.2 lekë/kg. Kjo llogari bëhet me çmimin e rritur nga 17 dinarë/kg në 22.5 dinarë/kg. Nga 1kg grurë del 950 gr miell dhe 1.42 kg bukë. Në Shqipëri një bukë 600 gr pa maja kushtonte 60 lekë, pas rritjes së çmimit kushton 80 lekë. Siç shihet është një abuzim i pastër. Edhe sikur të marrim çmimet 029 dhe 0.25\$/kg përsëri kemi abuzim të pastër. Tregtarët shpesh përdorin si shkak për

rritjen e çmimeve “Bursën”. Në fakt bursa është pretekst dhe jo shkak. Le të na tregojnë se për cilën Bursë e kanë fjalën, për të Serbisë, Ruisë apo ka ndonjë Bursë në Shqipëri? Çmimet e produkteve bujqësore në Bursa, ashtu si kurset e këmbimit ndryshojnë çdo ditë dhe nuk është “Bursa” ajo që i detyron tregtarët ta rritin çmimin. Po të qe bursa, në kohën e pandemisë çmimi i karburanteve do kishte shkuar 50 lekë. Sot ka informacion në internet që mund të lidhesh marrëveshje tregtare shumë efektive, pavarësisht nga Bursa. Kontratat hartohen jo ditore dhe jo mujore por për periudha afatgjata duke marrë në konsideratë edhe ndryshime të çmimeve. Firmat importuese të drithit si edhe vetë shteti sigurojnë rezervat e tyre pikërisht edhe për rastet e paparashikuara, duke i përdorur ato si elemente regullatore, por edhe nëse marrim Bursat e SHBA dhe të tjera do shikoni që përsëri kemi të bëjmë me abuzime. Nuk ndryshon çmimi i bukës në SHBA nga ndryshimi ditor i çmimeve të drithit.



Si frenohet rritja e çmimit të bukës si produkti kryesor i sigurimit të njësive ushqimore nga pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë? A mund të eliminohet prej politikave monetare apo prej politikave fiskale? Qeveritarët dhe institucionet e tjera autonome nuk duhet ta shikojnë rritjen e çmimeve në funksion të pagës sesa të ndryshimit të koston të tyre. Kur u rrit çmimi i ujit, “hë mo”, u tha, se nuk zë ndonjë peshë të madhe në pagë”. E njëjta gjë edhe për energjinë elektrike dhe po e njëjta gjë edhe për transportin edhe tash për bukë. Zotërinjtë qeveritarë duhet të bëjnë analizën e strukturës së koston para se të lejojnë rritjen e një çmimi dhe jo të thonë “hë mo se nuk zë peshë të madhe, nuk bëhet gjë se u rrit çmimi i biletës 10 lekë, apo çmimi i bukës 10 lekë”. Gjë nuk bëhet për atë që e ka pagën një milion mijë lekë, por për një pensionist me pagë 150 mijë lekë bëhet, sepse ai harxhon për ushqime dhe medikamente mbi 70% të saj.

Politikat monetare të Bankës Qendrore nuk kanë

asnjë efekt. Banka Qendrore e Shqipërisë ka shumë vite që ka dalë në pension. Inflacioni në Shqipëri nuk është një fenomen monetar, por i importuar dhe më së shumti abuzues. Banka e Shqipërisë ka që nga viti 2008, që e ka ulur normën bazë të interesit nga 6.25 në 0.5 dhe inflacioni ka qëndruar poshtë niveli minimal të parashikuar dhe në shumë raste ka pasë lidhje pozitive me NBI. Kështuqë nuk bëhet fjalë fare që BQ të ndërhyjë në treg dhe të stabilizojë situatën. BQ nuk e kontrollon dot normën e inflacionit.

Norma e inflacionit më së shumti, në Shqipëri është provokuar ngë vetë qeveritë e PD-PS nëpërmjet rritjes së çmimit të energjisë elektrike, të çmimit të ujit dhe të çmimeve të transportit, nëpërmjet sistemit të tatimeve në strukturën e çmimit të karburanteve, etj.

Qeveria mund të angazhojë dhe të bëjë më efektive punën e AKU, të kalibrimit. Përse e theksoj të kalibrimit? Sepse nëse ne shikojmë çmimin nuk shikojmë peshën. Pësia e një buke ka ardhur vazhdimisht në rënie, pavarësisht se çmimi nuk ka ndryshuar.

Autoriteti i Konkurrencës është Institucioni më kompetent për të provuar nëse ka

abuzim me çmimet apo jo, duke e nisur kontrollin që në burim - doganë - treg - përpunim dhe shitje.

Nëse çmimet nuk bien atëherë qeveria të indeksojë pagat dhe pensionet me indeksin e inflacionit çdo vit ose të bëjë politikë sociale duke ulur taksat dhe tatimet në të gjithë sistemin e prodhimit të bukës deri në shitje.

Duke e mbyllur theksoj se nëse ekonomia shqiptare do bazohej në prodhim dhe eksport atëherë nuk do kishim probleme të tilla. Shqipëria është vend i pasur, me njerëz punëtorë, por për fat të keq ka pasur pas viteve '90, qeveritarë që kanë punuar vetëm për xhepat e tyre dhe jo për biznesin e ndershëm dhe për popullin. Këtu unë nuk e ngatërroj biznesin, sepse biznesmenët tanë tregëtarët tanë e kanë mbajtur gjallë Shqipërinë pas viteve '90. Ata me intuitën e tyre kanë mundur të sjellin në Shqipëri mallra që mund të përballoheshin me pagat e shqiptarëve, pavarësisht nga cilësia e tyre.

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

Për rritjen e pjellorisë së tokës përdoren të gjitha llojet e plehërave organike, minerale dhe plehërimi i gjelbër. Plehërimi i gjelbër ndikon në përmirësimin e vetive fizike, fiziko-kimike, kimike dhe biologjike të tokës, qëndrueshmërinë e agregateve strukturalë për rrjedhojë rritje të rendmentit në kulturat bujqësore.

Nga studimet e kryera na rezulton që nga përmbysja e 100kv/ha masë e gjelbër lupin në tokë shtojmë 2.5-3.5 ton/ha lëndë organike, 45kg azot, 10-15kg fosfor dhe 17-25 kg potas. Shkalla e përvetësimit të elementëve ushqyes ndryshon. Në vitin e parë asimilimi i azotit është më i lartë sesa tek plehu i stallës duke arritur vlerën 40-45%. Kjo dukuri shpjegohet sepse në plehun e stallës pavarsisht nga masat që merren për pakësimin e humbjeve të azotit amoniakal, përsëri ato nuk evitohen, ndërsa tek plehërimi i gjelbër një dukuri e tillë nuk ndodh.

Me plehërimin e gjelbër grumbullohet një sasi më e pakët humusi. Kjo shpjegohet sepse në masën e gjelbër kemi një përmbajtje të lartë të karbohidrateve e proteinave, për rrjedhojë në të dallojmë një shkallë të lartë të intensitetit të proceseve biokimike gjatë mineralizimit të masës së freskët të lëndës bimore që përmbysset në tokë.

Veçori dalluese e veprimit të plehërimit të gjelbër është se nëpërmjet tij ruajmë lëndët ushqyese nga shpëlarja, duke shërbyer si depozitues të tyre në tokë, në mënyrë të veçantë ndikon në për ruajtjen e tokës nga erozioni e sidomos për kushtet e vendit tonë të ngastrave të sistemit malor e kodrinor ku kemi pakësim të gërryerjeve nga rreshjet deri në 60-65% në krahasim me ngastrat e pa mbjella. Zgjerimi i sipërfaqes me vreshta, pemëtoje dhe vreshta kërkon domosdoshmërisht përdorimin e plehërimit të gjelbër midis rreshtave në periudhën vjeshtë-pranverë duke rezultuar me kosto të ulët.

Kulturat që përdoren për plehërimin e gjelbër

Bimët që kultivohen për plehërim të gjelbër duhet të karakterizohen nga disa veçori:

- Të jenë me cikël të shkurtër rritje dhe zhvillimi;
- Brenda periudhës së vegetacionit të japin një masë bimore vegetative sa më të madhe;

PLEHËRIMI I GJELBËRT, QËLLIMI DHE RËNDËSIA E TIJ



- Të kenë një sistem rrënjor sa më të fuqishëm e të zhvilluar për të përvetësuar lëndët ushqyese të tokës;
- Të kenë pak kërkesa për kultivimin e tyre, për tokë dhe mjete të tjera për të siguruar prodhimin me kosto sa më të ulët.

Kulturat që përdoren për plehërim të gjelbër janë të shumta por më të rëndësishme janë: batha, lupini, melilotusi, bizelja, tërfili etj. Ato karakterizohen për cilësitë e tyre të veçanta biologjike në përputhje me kërkesat klimatiko tokësore dhe kushtet e kultivimit për sigurimin e një sasi e cilësie të përshtatshme për kultivimin e bimëve nëpërmjet plehërimit të gjelbër të bimëve bujqësore.

Batha është bimë leguminoze njëvjeçare që përshtatet mjaft mirë me kushtet klimatiko-tokësore të zonës së ulët bregdetare. Batha ka rrënjë boshtore me shumë degëzime. Thellësia e rrënjëve në tokë shkon 30-40cm, por pjesa më e madhe e tyre, gjendet në shtresën 0-20cm. Përveç rrënjëve boshtore, ka edhe shumë degëzime anësore, gjë që bën të mundur një lidhje më të mirë me tokën në shtresën e sipërme, duke minimizuar kështu erozionin sipërfaqësor që është shumë prezent në tokat kodrinore të zonës së ulët bregdetare që karakterizohet me reshje të shumta dhe intensitet të lartë të tyre.

Batha mbin në temperaturë 5-8°C dhe nga lulëzimi deri në pjekje, temperatura më e përshtatshme është 12-18°C. Në vendin tonë batha mund të mbillet si në vjeshtë edhe në pranverë herët (fundi i dimrit). Në zonën mesdhetare atlantike dhe tranzitore, mund të mbillet prej fundit të tetorit deri në 15 dhjetor. Tokat më të përshtatshme për mbjelljen e bathës janë ato subargjilore të rënda e deri në argjilore të lehta, me taban të thellë dhe të

freskëta. Në përgjithësi e pëlqen gëlqeren dhe reaksion neutral. Batha rritet mirë në pH 6.5-7.0, si bimë leguminoze kërkon toka të shkrufta me qëllim që të sigurojë një difuzion të mirë të ajrit, i cili është i nevojshëm për aktivitetin jetësor të bakterieve Rhizobium. Vetë bakteriet Rhizobium janë aerobe të detyruara, ndërsa procesi i fiksimit të azotit realizohet në kushte krejtësisht anaerobe.

Të dhënat e shumë autorëve vendas dhe të huaj kanë vërtetuar se batha reagon shumë mirë ndaj plehrave fosforike dhe potasike. Kjo lidhet me shumë me ndikimin pozitiv që ka fosfori dhe potasi në aktivitetin jetësor të bakterieve Rhizobium të jetës së lirë dhe aktivitetin e tyre në sistemin e simbiozës. Përdorimi i fosforit deri në 60 kg/ha dhe të potasit 75 kg/ha aftësia simbiotike dhe azotofiksuese rritet së tepërmi. Gjithashtu është vënë re, se turbekulat e formuara në sistemin rrënjor të bathës janë në numër shumë të madh se sa në tokat ku nuk është përdorur plehu fosfatik dhe potasik. Turbekulat janë më të mëdha, të rregullta, të vendosura më shumë në rrënjët kryesore se ato anësore dhe me ngjyrë rozë, gjë që flet për aktivitetin e lartë azotofiksues.

Mbjellja e bathës për plehërim të gjelbër mund të bëhet në rreshta ose shpërndarje, duke përdorur 150-200 kg/ha. Thellësia e mbjelljes është 6-10 cm në varësi të përbërjes mekanike të tokës. Periudha më e përshtatshme është muaji tetor-nëntor ose herët në pranverë. Përmbysja e masës së gjelbër mbetokësore zakonisht bëhet në fazën e lulëzimit masiv ose të lidhjeve të bishtajave. Sigurisht që kjo kohë përcaktohet edhe nga kultura që do të mbillet pas saj. Sigurisht është mirë që pranvera të shfrytëzohet për grumbullimin e masës së gjelbër në mënyrë që efektiviteti i saj të jetë më i madh.

Para se masa bimore e gjelbër të përmbysset, toka diskohet me qëllim që bimët të coptohen në madhësi 20-30cm. Përmbysja e masës së gjelbër mund të bëhet me plugje të zakonshme ose speciale në thellesi 30-40 cm. Në këtë thellësi dekompozimi i masës së gjelbër bëhet ngadalë dhe si rezultat lëndët ushqyese të çliruara shfrytëzohen më me efektivitet nga bima pasardhëse. Nisur nga fakti që

bimët leguminoze në përbërjen kimike të tyre kanë shumë proteina dhe pak lignin, celulozë dhe hemicelulozë, ato mineralizohen shpejt duke kaluar pjesa më e madhe e tyre në produkte përfundimtare dhe duke përfaqësuar kështu nga një koeficient shumë i ulët humifikimi.

Për të zgjatur kohën e dekompozimit të masës së gjelbër të bimëve leguminoze të përmbysura dhe për të rritur koeficientin e humifikimit është më mirë që masës se përmbysur ti shtohet kashtë të lashtash në masën 30-40 kv/ha ose të përdoren mbjellje të përziera bimë leguminoze + bimë graminore. Pavarsisht nga përparsitë që kanë dhe duhet t'u jepet bimëve bishtajore në plehërimin e gjelbër, në rritjen e pjellorisë së tokës kanë ndikojnë dhe kultura të tjera (graminore) jo bishtajore që shpesh herë përdoren dhe në bashkëshoqërim me bishtajoret.

Kushtet e efektivitetit të plehërimit të gjelbër

Efektiviteti i plehërimit të gjelbër lidhet me një sërë faktorësh siç janë bimësia, sasia e masës që përmbysset, koha e përmbysjes, thellësia, kushtet klimatiko tokësore

- Nga cilësia e masës së gjelbër të përmbysur. Sa më e drunjëzuar të jetë ajo, aq më i ngadalshëm bëhet mineralizimi dhe anasjelltas.

- Nga përbërja mekanike e tokës. Në tokat e ngjeshura me përbërje mekanike të rëndë është më i ngadalshëm sepse qarkullimi i ajrit është i dobët. E kundërta ndodh në tokat e lehta ranore, ku difuzioni i ajrit bëhet me lehtësi dhe proceset mikrobiologjike bëhen më të shpejta.

- Thellësia e përmbysjes së masës së gjelbër shpejton ose ngadalëson mineralizimin e saj. Me përmbysjen e thellë, mineralizimi bëhet i ngadalshëm për faktin se aktiviteti mikrobiologjik është më i dobët, si rezultat i mungesës së ajrit në profilin e tokës dhe e kundërta ndodh me përmbysjen e cekët të masës së gjelbër.

- Në temperaturë optimale, dekompozimi bëhet i shpejtë, në temperaturë të ulët, ngadalësohet ose ndërpritet.

- Nga lagështia e tokës. Në lagështirë optimale mineralizimi bëhet i shpejtë, në thatësi ngadalësohet ose ndërpritet. Sipas studimeve të realizuara në kushte të kontrolluara fushore, kur toka ka 60% lagështirë të kapacitetit fushor, proceset e mineralizimit arrin në maksimum.

Përgatitën: Dr.Zhaneta Hasani,
Dr. Shpëtim Tafaj.

Drejtorja e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;
QTTB-Fushë Krujë: E-mail:qttbfushekruje@yahoo.com

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

Këshilla për fermerët kultivues të misrit, tetor 2021

- Kryefjala e këtij muaji vazhdon të jetë korja e misrit si për silazh ashtu edhe për kokërr. Reshjet e shiut pengojnë vjeljen e prodhimit dhe risin nivelin e dëmit në ngastër.
- Në këto kushte fermerët duhet të shfrytëzojnë maksimalisht kohën për vjeljen e prodhimit në të dy format, e përdorimit si silazh me kallinj apo kokërr dhe depozitim e tij në vendruajtje apo përpunimi si gropa të silazhimit, tharëse apo depo.
- Cilësia e silazhit të misrit me kallinj lidhet me shpejtesinë e kryerjes së operacioneve Korje+Depozitim+Ngjeshje, të cilat duhet të kryhen sa më shpejt të jetë e mundur.
- Misri i destinuar për prodhim kokërr duhet të korret kur lagështia në kokërr ka rënë nën nivelin 18%. Në këto kushte minimizohen thyerjet në kokërr nga korja dhe reduktohen shpenzimet për tharje.
- Në varësi të kushteve, misri mund të thahet në tharëse të posaçme ose mund të ruhet si kalli në kotece të përgatitur paraprakisht.
- Pas vjeljes së prodhimit rekomandohet grirja e kashtës dhe përmbysja e saj me plugim (aty ku e lejojnë kushtet dhe mundësitë e fermerit). Një masë e tillë agroteknike ndikon në uljen e rezervave të sëmundjeve apo dëm-tuesve të depozituara në tokë dhe njeherësh ndikon në dekompozimin e mbetjeve bimore duke përmirësuar treguesit e tokës.
- Fermerët duhet të marrin masa edhe për kullimin e ngastrave nese ato janë të destinuara për kultivim të misrit në vitin pasardhës.

Drejtoria e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUGË

Përdorimi i Teknologjisë Informacionit në fermat blegtorale

- Teknologjia informacionit (IT) është një term i përgjithshëm që përshkruan çdo teknologji që ndihmon për të prodhuar, manipuluar, ruajtur, dhe/ose shpërndarë informacionin kur flasim për IT në tërësi. Përdorimi i kompjuterit dhe informacionit shoqërojnë njëra-tjetrën. Teknologjia infromacionit (IT) është përdorur gjerësisht për studimin dhe përmirësimin e aspekteve të ndryshme të prodhimit gjësë gjallë. Teknologjia informacionit është përdorur me sukses për menaxhimin e qëndrueshëm të gjësë së gjallë, mbarështimin, të ushqyerit, kontrollin, diagnostifikimin dhe trajtimin e sëmundjeve. IT ka një rol të madh në shpërndarjen e informacionit të lidhur me gjënë e gjallë. Në ditët e sotme celulari duket si mjeti shumë i rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit. Informacioni i lidhur me blegtorinë mund të jepet nëpërmjet kompanive që ofrojnë shërbimin mobile. IT po përhapet me hapa të shpejta edhe në vendin tonë. Duket që në të ardhmen do të kemi një platform të shëndoshë për shërbime komunikimi dhe ofrimin e shërbimeve në zonën rurale nëpërmjet IT bazuar në paisje dhe shërbime me vlerë të shtuar.
- Teknologjia informacionit ofron potencial të madh në përmirësimin e shëndetit të kafshëve, nëpërmjet masave të ndryshme si përmirësimi racor nëpërmjet programeve racore, mbështetje institucionale me kredi, përmirësime në shërbimet e gjësë gjallë si inseminimi artificial, vaksinimi, në prodhimin dhe përpunimin e produkteve shtazore, ruajtjen dhe transportin e produkteve, politika të përshtatshme import-eksporti të produkteve blegtorale dhe përveç këtyre për të adresuar nevojat në informacion për sisteme të ndryshme blegtorale, nëpërmjet sistemit bazuar në shërbimin e ekstensionit, parashikimin efektiv të sëmundjeve, vënien e një diagnoze të saktë dhe të shpejtë të sëmundjes, masa terapeutike moderne, informacion mbi stokun gjenetik të kafshëve dhe të gjitha aspektet të lidhur me rritjen e kafshëve.
- Si teknologjia e informacionit mund të ndihmojë fermerët?**
- Disa nga rolet e teknologjisë së informacionit në sektorin blegtoral përfshijnë: produktivitetin e përmirësuar. Fermerët kanë nevojë për informacion mbi materialin racor më të mirë në treg, teknikat e avancuara në prodhim dhe praktikat blegtorale të përmirësuara. Sistemi i informacionit për menaxhimin e fermave (FMIS) në blegtori ka evoluar nga mbajtja thjesht e rekordeve në fermë në sisteme të sofistikuara dhe komplekse për të mbështetur menaxhimin e prodhimit dhe plotësuar kërkesat në rritje për të ulur koston e prodhimit, plotësimin e standardeve duke ruajtur cilësi dhe siguri të lartë të produktit. IT mund të ndihmojë në rritjen ose përmirësimin e produktivitetit, mirëqenies ose mbarështimit të kafshëve. Koncepti i "lopes së lidhur" është një rezultat gjithnjë e më shumë i tufave të qumështit të përshtatur me sensorë për të monitoruar shëndetin dhe rritjen e produktivitetit dhe për tregtimin e gjësë së gjallë dhe produkteve shtazore. Gjithashtu bëjnë të mundur monitorimin e aktivitetit riprodiktiv, të shëndetit, statusit në lidhje me mirëqenien e kafshëve, përmirësimin e kushteve të punës.
- Përfitimet e përdorimit të teknologjisë së informacionit janë të shumta dhe përfshijnë: Rritjen e efektivitetit të shpenzimeve, përmirësimin e mirëqenies së kafshëve dhe prodhimtari më e lartë. Kjo krijon mundësi për rritjen e aksesit në tregje blegtorale. RFID (radio-frequency identification), sensorët biometrikë dhe GPS lejojnë monitorimin e kafshëve të fermës. Menaxherët e prodhimit duhet të jenë të aftë për t'iu përgjigjur problemeve që dalin në fermat blegtorale. Sistemi i identifikimit dhe gjurmimit të kafshëve është përdorur për qëllime të ndryshme të tillë si gjurmimi i lëvizjes kafshëve, monitorimi i shëndetit, kontrolli i sëmundjeve, të ushqyerit dhe prodhimi.

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB-Fushë Krugë:
E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

Këshilla për fermerët që kultivojnë bimë aromatike mjekësore, tetor 2021

- Nëse muaj shtator nuk kishte ndonjë ngarkesë për fermerët në lidhje me kulturat e BAM, në muajin tetor fillojnë punimet për një cikël të ri prodhimi që ka të bëjë kryesisht me:
1. Punimet dhe plehërimet organike të tokës
 2. Mbjelljet e reja
- Bimët Aromatiko-Mjekësore përgjithësisht janë bimë shumëvjeçare; janë shumë rezistente ndaj thatësirave të verës që karakterizohen nga një periudhë qetësie të shkurtër.
 - Vjeshta është një periudhë zgjimi dhe pune për pjesën më të madhe të tyre. Riaktivizimi i tyre për një proces vegetativ bëhet shumë shpejt mbas shirave të vjeshtës.
 - Mbasi kanë kaluar periudhën e verës në kushte të thatësirës; me rënien e shirave të vjeshtës kemi një zgjim të shpejtë të tyre, me një vegetacion të fuqishëm (sidomos bima e Sherebelës që zë dhe sipërfaqen më të madhe të BAM), për këtë arsye duhet të ushtrohet kujdesi i nevojshem për të marrë një prodhim të dytë.
 - Plugimi i tokave, plehërimet bazë dhe përgatitjet e tyre për mbjelljet e vjeshtës duhet të jenë përfunduar ose duhet të përfundojnë në mënyrë më urgjente.
 - Shumë fermerë kanë mbjellë farishte gjatë verës dhe kanë fidana të përgatitur dhe të gatshëm për t'i mbjellë në fushë (vendin e përhershëm). Muaji tetor është koha më e përshtatshme (falë kushteve që po krijohen me rënien e shirave në këtë periudhë), për të filluar mbjellejn e fidanave në vendin e përhershëm të bëhet piketimi i parcelave ku do të bëhet mbjellja.
 - Në magazinat e grumbulluesve, hangarët e fermerëve etj., ku janë të depozituara BAM duhet të merren masa për ajrosjen e prodhimeve mbasi me rritjen në vazhdimësi të lagështirave mbi 80% ekziston rreziku i dëmtimit të prodhimit (sidomos bimët që janë korrur me vonesë dhe nuk janë tharë sipas standarteve).
 - Për ndonjë prodhim të mbetur në hangare të pashitur akoma, fermerët të kontaktojnë me grumbullues dhe të bëjnë paketimin dhe ambalazhimin e prodhimit të BAM, mbasi lagështira e madhe në këtë periudhë dhe faktorë të tjerë atmosferikë mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e prodhimit.

Drejtoria e Teknologjive Bujqësore, QTTB-Shkodër,
E-mail: qttbshkoder@yahoo.com

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE KORÇË

Këshilla për fermerët që mbarështojnë bagëti të imta

- Fermerë!**
- Kjo rubrikë këshillash është për të ushqyerit e dhenve në fazën e dytë të barsmërisë, para pjelljes.
- Kjo periudhë është kritike në të ushqyerit e dhenve sepse kapaciteti ngrënës është i ulët 1.2 kg LTH, (pra sa gjysma e kapacitetit ngrënës të një deleje në muajin e dytë të laktacionit), ndërsa nevojat në lëndë ushqimore janë të larta. Një i ushqyer deficiëtar gjatë kësaj periudhe do të sjellë:
- Uljen e peshës së qingjave në lindje.
 - Dobësim të deleve si rezultat i harxhimit të rezervave trupore.
- Prandaj për këtë periudhë duhet të bëhet të ushqyerit korrekt të deles për të evituar pasojat negative të përmendura më lart dhe për të garantuar këto objektiva:
- Qingja me peshë më të lartë në lindje.
 - Prodhimtari qumështi më të lartë si në fazën e mëmëzimit të qingjave ashtu edhe mjeljes.
- Ju këshillojmë që për këtë periudhë të përdoret ky racion ushqimor në mënyrë orientuese dhe sipas mundësive konkrete të bazës ushqimore:
- Për zonat fushore dele me peshë 45-50 kg**
- | Llojet e ushqimeve | 6 javë para pjelljes |
|------------------------|----------------------|
| Kullotë | 4-6 kg |
| Bar ose jonxhë e thatë | 0.2 kg |
| Tagjira | 0.2 kg |
- Për zonat malore dele me peshë 45-50 kg**
- | Llojet e ushqimeve | 6 javë para pjelljes |
|----------------------|----------------------|
| Jonxhë cilësi e mirë | 1.2 kg |
| Tagjira | 0.2 kg |
- Kullotë nëse ekziston mundësia**
- Ju kujtojmë se duhet të përfundoni menjëherë (një muaj para pjelljes) masat parambrojtëse si vaksinimi kundër Enterotoxemisë (zorëza), Agalaksisë (hirëza), Paratifos (dështimet) dhe në rastet ku është problem sëmundja e mishit të bardhë në qingja, bëni trajtim parambrojtës të deleve barsa me Selen dhe vit E. Për të gjitha këto këshillohu me specialistin veterinar.
- Për fermat e dhive:**
- Vazhdoni të mbani në kontroll tufën e dhive në këto drejtime:
- Ndërzimin e dhive të mbetura.
 - Ndërzimin e dhive për kthimet e mundëshme të afshit brenda cikleve.
 - Shikoni gjëndjen e cjepëve dhe mos tejkaloni ngarkesën e tyre.
 - Mos ndryshoni ritmin e të ushqyerit të dhive dhe për dhitë e dobëta bëni trajtim të veçantë me koncentre.
 - Zbatoni masat parambrojtëse shëndetësore sipas kalendarit të shërbimit veterinar.
 - Këshillohu me veterinerin.

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Korçë:
E-mail: qttbkorce@yahoo.com

Pamja e qiellit gjatë muajit nëntor 2021

Më 4 nëntor - Hëna e Re.
Hëna do të vendoset në të njëjtën anë të Tokës me Diellin

Parashikimi i motit për muajin nëntor 2021 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli
	U	L		mm	Orë	Km/Orë		Drejtimi				
						D	N	D	N			
1	13	23	13-23-23	0	0	7	6	LJL	L	1	Kryesisht me re	
2	14	23	14-22-22	0	0	7	4	L	LVL	1	Kohë me re	
3	14	23	14-23-22	0	0	7	2	LJL	VVL	2	Pjesërisht me Diell	
4	13	22	12/22/2022	4	3	7	7	L	L	1	Përzjerje e diellit me re me ndonjë stuhi	
5	14	22	12/21/2021	9.3	5	9	6	LJL	LJL	1	Kohë me re	
6	14	21	14-21-21	6.5	3.5	6	6	LJL	L	1	Kryesisht me re me disa shira dhe ndonjë stuhi	
7	13	22	14-22-21	0	0	7	4	LVL	LVL	1	Intervale me re dhe kohë me diell	
8	13	22	13-22-22	0	0	7	4	LJL	LJL	2	Kohë me re dhe diell	
9	14	22	10/22/2021	16.7	10	9	11	LJL	JJL	2	Kryesisht me re me ndonjë shi të vogël në pasdite	
10	14	21	10/19/2019	19.8	8	13	15	JJL	LJL	1	Kohë me re me shira dhe stuhi	
11	8	18	2/17/2016	0	0	24	30	LVL	LVL	3	Kohë me re dhe diell	
12	8	18	4/17/2015	0	0	22	20	L	L	3	Pjesërisht me Diell	
13	8	18	0-18-16	11.6	5.5	15	24	LJL	LVL	3	Kryesisht me re me ndonjë shi të vogël në pasdite	
14	9	19	3/16/2016	5.9	4	33	33	LVL	LVL	1	Kohë me re dhe erë me ndonjë shi të vogël	
15	9	17	3/14/2014	6	4	32	28	LVL	L	1	Vranësira të konsiderueshme me ndonjë shi të vogël, Erë	
16	8	17	3/15/2015	0	0	24	22	L	L	1	Re të ulta	
17	7	17	3/16/2015	0	0	19	20	L	L	2	Diell dhe pak re	
18	7	17	2/17/2015	0	0	17	19	L	L	2	Kryesisht me Diell	
19	7	16	2/17/2015	0	0	15	19	L	L	2	Kryesisht me Diell	
20	6	16	2/16/2014	0	0	17	17	L	LVL	2	Kryesisht me Diell	
21	6	16	1/16/2015	0	0	15	17	LVL	LVL	2	Kryesisht me Diell	
22	6	16	3/16/2015	0	0	13	13	LVL	LVL	2	Kryesisht me Diell	
23	6	16	5/18/2016	0	0	7	9	LVL	L	2	Kryesisht me Diell	
24	11	15	9/18/2016	0	0	4	7	JJP	JP	2	Plot me Diell	
25	11	17	10/16/2016	0.8	1.5	13	11	JJP	J	1	Kryesisht me re;një shi me pika në mëngjez i ndjekur nga një shi i vogël në pasdite	
26	10	19	8/19/2019	0	0	6	9	PJP	VL	1	Diell dhe zona me re të ulta	
27	11	20	11/20/2019	0	0	9	7	L	JL	2	Diell dhe pak re	
28	11	19	9/20/2018	1.5	2	7	9	JJP	JJP	2	Interval me re dhe kohë me diell	
29	9	20	3/18/2018	13	6.5	13	19	JJP	J	1	Kryesisht me re me ndonjë shi në kalim	
30	7	19	5/17/2017	22.6	12	20	11	JJP	JJL	1	Re me shira dhe stuhi	

dhe nuk do të jetë e dukshme në qiellin e natës. Kjo fazë do të ndodhë në orën 22:14 UTC. Kjo është koha më e mirë e muajit për të vëzhguar objekte të zbehta të tilla si galaktikat dhe grupimet e yjeve, sepse nuk ka dritë hëne për të ndërhyrë.

Më 4 dhe 5 nëntor, Dush Meteor Taurids. Tauridët janë një shi i vogël meteorësh i gjatë që prodhon vetëm rreth 5-10 meteorë në orë. Është e pazakontë në atë që ky dush përbëhet nga dy rrjedha të ndara. E para është prodhuar nga kokrrat e pluhurit të lënë pas nga Asteroidi 2004 TG10. Rrjedha e dytë prodhohet nga mbeturinat e lëna pas nga kometa 2P Encke. Dushi ndodh çdo vit nga 7 shtatori deri më 10 dhjetor. Do të kulmojë këtë vit natën e 4 nëntorit. Hëna e re do të lërë qiellin e errët këtë vit për atë që duhet të jetë një shfaqje e shkëlqyer. Shikimi më i mirë do të jetë vetëm pas mesnate nga një vend i errët shumë larg dritave të qytetit. Meteorët do të rrezatojnë nga plejada Demi, por mund të shfaqen kudo në qiell.

Më 5 nëntor - Urani në Opozitë. Planeti blu-jeshil do të jetë në afrimin më të afërt me Tokën dhe faqja e tij do të ndriçohet plotësisht nga Dielli. Do të jetë më i ndritshëm se çdo kohë tjetër e vitit dhe do të jetë i dukshëm gjatë gjithë natës. Kjo është koha më e mirë për të parë Uranin. Për shkak të distancës së tij, ai do të shfaqet vetëm si një pikë e vogël blu-jeshile në teleskopët

më të fuqishëm.

